



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 91, datë 30.09.2020

PËR

VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 4 BANESAVE PRIVATE TË NDODHURA NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5, DURRËS TË GJITHA PRONË PRIVATE NË ZBATIM TË EKSPERTIZAVE TË THELLUARA TË HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,


**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 4 objekteve në pronësi private të ndodhura në Njësinë Administrative nr.5, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, sipas listës bashkëngjitur.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK


Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.09.2020

	PROT/DATE	OBJEKTE	Nr. KATI	ADRESA	G.I.S / KORDINAT A	PRISHJE/R IFORCIM	NJESIA ADMINIST RATIVE
1	6625. DT 11.06..2020 NR. 1269, DT. 06.06..2020 ISTN	BANESE	1kat	Rajoni 5, Rruga "Abdullah Tabaku" Nd. 13	42	PRISHJE	RAJONI 5
2	6625. DT 11.06..2020 NR. 1269, DT. 06.06..2020 ISTN	BANESE	1kat	Rajoni 5, Rruga "Abdullah Tabaku" Nd. 4	36	PRISHJE	RAJONI 5
3	6625. DT 11.06..2020 NR. 1269, DT. 06.06..2020 ISTN	BANESE	1kat	Rajoni 5, Rruga "Abdullah Tabaku" Nd. 6	38	PRISHJE	RAJONI 5
4	6625. DT 11.06..2020 NR. 1269, DT. 06.06..2020 ISTN	BANESE	1kat	Rajoni 5, Rruga "Abdullah Tabaku" Nd. 13/1	43	PRISHJE	RAJONI 5








REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 899 / prot.
3



Durrës, më 02.10.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.91 datë 30.09.2020 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 4 banesave private të ndodhura në njësinë administrative nr. 5, Durrës, të gjitha pronë private, në zbatim të ekspertizave të thelluara të hartuara nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

